



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

01-016/01-00-78019/21
26.12.2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe rekomandimin e komisionit për thjeshtëzimin e shërbimeve Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

1. Me këtë Vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohen nga data 01 janar 2026.

Shtojca 1; Shërbimet e thjeshtuara të Komunes së Mitrovicës së jugut

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunes
- 1x1 Zyres ligjore
- 1x1 Zyres për informim
- 1x1 Drejtorëve të drejtorive Komunale
- 1x1 Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- 1x1 Zyres së Kryeministrit



Kryetari i Komunes
Anton Peci